BAS... A MA...
Z... e Pr...
Nr. 6542 Pro...
Date 30.10.26
Nëlishkrimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
NJËSIA ADMINISTRATIVE POJAN

Nr. 1652 prot. Pojan më 28.10.2026

Lënda: Kërkesë për miratimin e vendosjes së bustit dhe dekorimin e patriotit Orhan Bej Pojani me titullin "Qytetar Nderi" i Bashkisë Maliq.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Maliq .

-Këshillë dt 30.10.2026

I nderuar Z.Gëzim Topçiu,
I nderuar Z.Ornildi Demollari,
Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Nëpërmjet kësaj kërkese, unë Kreshnik Azo Administrator i Njësisë Administrative Pojan në bashkëpunim me kryetarin e fshatit Pojan Xhafer Gjyshllari dhe kryetarin e Shoqatës Atdhetare Kulturore Pojan Klajdi Lulollari propozojmë që Këshilli Bashkiak të shqyrtojë mundësinë për miratimin e vendosjes së bustit dhe dekorimin e patriotit Orhan Bej Pojani me titullin "Qytetar Nderi" i Bashkisë Maliq , me motivacion :

"Për kontributin e shquar në Lëvizjen Kombëtare Shqipëtare , për veprimtarinë e tij të shquar patriotike në trevën e Korçës dhe më gjërë , në shërbim të çështjes kombëtare , përhapjen e gjuhës shqipe dhe zhvillimin e arsimit kombëtar si dhe për rolin e tij në forcimin e ndërgjegjjes kombëtare dhe ruajtjen e identitetit shqiptar "

Bashkangjitur kësaj kërkese po ju paraqesim edhe dokumentacionin që dëshmon veprimtarinë dhe kontributin e patriotit Orhan Bej Pojani .

Duke ju falënderuar për vëmendjen dhe mirëkuptimin, mbetemi në pritje të shqyrtimit të kësaj kërkese.

ADMINISTRATORI

Kreshnik Azo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË NJËSIA ADMINISTRATIVE POJAN BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
NJËSIA ADMINISTRATIVE POJAN
KRYETARI I FSHATIT POJAN
SHOQATA ATDHETARE KULTURORE "POJANI"

Pojan, 12.10.2026

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë Maliq, Z. Gëzim Topçiu
Kryetarit të Këshillit Bashkiak Maliq, Z. Ornildi Demollari
Këshillit Bashkiak Maliq

Lënda: Propozim për miratimin e vendosjes së bustit dhe dekorimin e patriotit Orhan Bej Pojani me titullin "Qytetar Nderi" i Bashkisë Maliq.

I nderuar Z. Gëzim Topçiu
I nderuar Z. Ornildi Demollari
Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Nëpërmjet këtij propozimi, kemi nderin t'ju drejtohemi për të kërkuar shqyrtimin dhe miratimin e vendosjes së bustit të patriotit Orhan Bej Pojani, si dhe dekorimin e tij me titullin "Qytetar Nderi" i Bashkisë Maliq me këtë motivacion: **"Për kontributin e shquar në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare; për veprimtarinë e tij të çmuar patriotike në trevën e Korçës dhe më gjerë, në shërbim të çështjes kombëtare, për përhapjen e gjuhës shqipe dhe zhvillimin e arsimit kombëtar, si dhe për rolin e tij në forcimin e ndërgjegjes kombëtare dhe në ruajtjen e identitetit shqiptar."**

Orhan Bej Pojani (1846-1913), përfaqëson një figurë të shquar të historisë sonë kombëtare dhe lokale, i cili me veprimtarinë e tij patriotike, kontributin në çështjen kombëtare dhe përkushtimin ndaj atdheut, ka lënë gjurmë të pashlyeshme në ndërgjegjen historike të zonës sonë dhe më gjerë. Vepra e tij përbën një shembull frymëzimi për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Vendosja e bustit të tij në lulishten e ish-Pallatit të Kulturës Pojan (Sheshi Orhan bej Pojani), do të shërbente si një akt nderimi dhe mirënjohjeje institucionale, si dhe një vlerë kulturore, historike dhe edukative për komunitetin. Po ashtu, dhënia e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Maliq do të ishte një vlerësim i merituar për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në shërbim të kombit dhe vendlindjes.

Duke pasur parasysh sa më sipër, ju lutemi që ky propozim të merret në konsideratë dhe të përfshihet për shqyrtim në një nga mbledhjet e ardhshme të Këshillit Bashkiak, në përputhje me

procedurat ligjore në fuqi.

Bashkëlidhur gjeni: Biografinë e Orhan Bej Pojanit dhe foton e vendit ku do të vendoset busti. Ju lutem të na njoftoni me shkresë zyrtare lidhur me vendimin që do të merrni, si dhe të na përcillni kopjen e vendimit dhe miratimit përkatës.

Ju falënderojmë për vëmendjen dhe angazhimin tuaj në ruajtjen dhe promovimin e vlerave historike e patriotike të Bashkisë Maliq.

KRYETARI I FSHATIT POJAN

XHAFER GJYSHLLARI

KRYETARI I SHOQATËS

KLAJDI LULOLLARI

POJANI ORHAN

✣ (1846-1913). Udhëheqës i Lëvizjes për çlirimin kombëtar nga zgjedha osmane në trevën e Korçës. Lindi në Pojan të Korçës. Mori pjesë në lëvizjen kombëtare që në moshë të re. Me Jovan Cico Kosturin dhe Thimi Markon themeloi më 1886 në Korçë Komitetin e Fshehtë që u mor me përhapjen e ideve kombëtare. U shqua për organizimin e lëvizjes arsimore, për përhapjen e gjuhës dhe shkrimit shqip, ndihmoi pë çeljen e Mësonjëtores së Parë Shqipe në Korçë më 1887 dhe në mbarëvajtjen e saj. Për veprimtarinë e tij patriotike më 1903 u arrestua dhe u internua në Anadoll'. Pas shpalljes së kushtetutës (1908) punoi për organizimin e shoqërive dhe klubeve patriotike në Korçë, u zgjodh kryetar i Klubit «Dituria», delegat i Korçës në Kongresin e Elbasanit dhe kryetar i shoqërisë qendrore shkollore «Përparimi». Përkrahu kryengritjet e viteve 1910-1912 dhe përshëndeti Kuvendin Kombëtar të Vlorës. Në shtator të vitit 1913 shkoi në Vlorë për të takuar Ismail Qemalin. Pas disa ditëve vdiq dhe u varros në Vlorë.

Akademia e Shkencave e Shqipërise, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, 1985, fq. 854-855

Kryetari Fshatit
Pojan
Xhafer Gjyshllari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDESIA ADMINISTRATIVE
KRYETARI I FSHATIT
POJAN
POJAN
BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
NJËSIA ADMINISTRATIVE POJAN

Pojan, 12.10.2026

Vërtetojmë **se Orhan bej Pojani** (1846-1913) sipas Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, 1985, fq. 854-855 ka qënë udhëheqës i Lëvizjes për çlirimin kombëtar nga sundimi osman në trevën e Korçës. Lindi në Pojan të Korçës. Mori pjesë në lëvizjen kombëtare që në moshë të re. Me Jovan Cico Kosturin dhe Thimi Markon themeloi më 1886 në Korçë Komitetin e Fshehtë që u mor me përhapjen e ideve kombëtare. U shqua për organizimin e lëvizjes arsimore, për përhapjen e gjuhës dhe shkrimit shqip, ndihmoi pë çeljen e Mësonjëtores së Parë Shqipe në Korçë më 1887 dhe në mbarëvajtjen e saj. Për veprimtarinë e tij patriotike më 1903 u arrestua dhe u internua në Anadoll. Pas shpalljes së kushtetutës (1908) punoi për organizimin e shoqërive dhe klubeve patriotike në Korçë, u zgjodh kryetar i Klubit «Dituria», delegat i Korçës në Kongresin e Elbasanit dhe kryetar i shoqërisë qendrore shkollore «Përparimi». Përkrahu kryengritjet e viteve 1910-1912 dhe përshëndeti Kuvendin Kombëtar të Vlorës. Në nëntor të vitit 1913 shkoi në Vlorë për të takuar Ismail Qemalin. Pas disa ditëve vdiq dhe u varros në Vlorë.

ADMINISTRATORI

KRESHNIK AZO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË NJËSIA ADMINISTRATIVE POJAN BASHKIA MALIQ



Vendi ku do të vendoset busti është lulishtja para ish-Pallatit te Kultures Pojan

SHKIA MA
Prot
Nr. 6606 Prot
Date 4.11.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQATA ATDHETARE-KULTURORE GORA

KËRKESË

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ

LËNDA: PROPOZIM PËR EMËRTIM EMRI

Kryesia e Shoqatës Atdhetare-Kulturore 'Gora' i drejtohet me propozim për: emërtim të një rruge, sheshi apo hapsire publike në teritorin e bashkisë, Këshillit Bashkiak Maliq, për znj. Donika Rroko (Hoxhalli), në emrin e saj.

- Këshillit
dt 04.11.2026

SHOQATA ATDHETARE KULTURORE GORA ANE ALBANIA 98

Mbi veprimtarinë dhe kontributin e znj. Donika Rroko (Hoxhalli) në Shoqatën Atdhetare Kulturore "Gora" dhe komunitetin e zones.

Në cilësinë e Kryetarit të Shoqatës Atdhetare-Kulturore "Gora", nëpërmjet këtij relacioni paraqesim veprimtarinë dhe kontributin shumëvjeçar të znj. Donika Rroko, lindur më 21.06.1958 dhe ndarë nga jeta më 03.03.2026, si një prej anëtareve aktive dhe kontribuuese të Shoqatës, si dhe kontributin e saj profesional, ekonomik dhe shoqëror në komunitetin e Gorës dhe të Maliqit. Znj. Donika Rroko ka qenë e lidhur ngushtë me krahinën e Gorës dhe territorin e Maliqit, lidhje e krijuar që në fëmijëri dhe e ruajtur përgjatë pjesës më të madhe të jetës së saj. Ajo ka jetuar në Senisht, ndërsa arsimin 8-vjeçar e ka kryer në Lozhan. Në vitin 1977 përfundoi shkollën e Merkologjisë në Vlorë, duke u formuar profesionalisht në fushën e tregtisë me vlerësim ekselent (sipas vlerësimit sot). Pas përfundimit të shkollës filloi punë si shitëse, detyrë të cilën e ushtroi për rreth 3–4 vjet. Në vijim të veprimtarisë së saj profesionale, znj. Donika Rroko mori përgjegjësi drejtuese në sektorin e tregtisë, duke ushtruar fillimisht detyrën e Përgjegjëses së Degës së Tregtisë në Lozhan dhe, më pas, detyrën e Përgjegjëses së Tregtisë së qytetit të Maliqit, funksion të cilin e ushtroi deri në vitin 1991. Gjatë kësaj periudhe ajo ka qenë pjesë aktive e jetës ekonomike dhe shoqërore të zonës, duke mbajtur funksione me përgjegjësi në drejtimin dhe organizimin e sektorit të tregtisë në Lozhan dhe Maliq. Veprimtaria e saj profesionale në vitet përpara ndryshimeve të sistemit ekonomik të fillimit të viteve '90 përbën një pjesë të rëndësishme të kontributit të saj shumëvjeçar në komunitetin e zonës. Pas vitit 1991, ajo vijoi të kontribuonte në jetën ekonomike lokale nëpërmjet aktivitetit privat. Deri në vitin 2010, për afro dy dekada, ushtroi aktivitet tregtar në dyqanin e saj në Drithas, duke ruajtur kështu lidhjen e drejtpërdrejtë me komunitetin dhe jetën ekonomike të zonës. Veprimtaria në Shoqatën Atdhetare-Kulturore "Gora" krahas aktivitetit profesional dhe ekonomik, znj. Donika Rroko ka dhënë një kontribut të veçantë në veprimtarinë e Shoqatës Atdhetare-Kulturore "Gora" dhe në organizimin e komunitetit gorar. Gjatë periudhës kur jetonte dhe ushtronte aktivitetin e saj në Drithas, ajo ka mbajtur funksionin e Kryetares Rajonale të Shoqatës Atdhetare-Kulturore "Gora". Në këtë cilësi, znj. Donika Rroko ka qenë ndër nismëtaret kryesore të organizimeve, mbledhjeve, takimeve dhe veprimtarive të Shoqatës për komunitetin gorar, duke dhënë një kontribut të drejtpërdrejtë në organizimin dhe afrimin e anëtarëve të komunitetit dhe në trajtimin e çështjeve me interes të përbashkët për Gorën dhe banorët e saj. Kontributi i saj nuk ka qenë vetëm pjesëmarrës, por edhe drejtues, organizativ dhe nismëtar, duke marrë përgjegjësi konkrete për zhvillimin e veprimtarive dhe për ruajtjen e lidhjeve ndërmjet anëtarëve të komunitetit. Vijimi i kontributit pas transferimit në Tiranë Pas vitit 2010, kur u transferua për të jetuar në Tiranë, znj. Donika Rroko nuk u shkëput nga Gora dhe nga veprimtaria e Shoqatës. Përkundrazi, ajo vijoi angazhimin e saj duke ushtruar rolin e Sekretares së Shoqatës Atdhetare-Kulturore "Gora"në Tiranë. Në këtë funksion, krahas pjesëmarrjes në organizimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të Shoqatës, ajo ka luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin, ndërmjetësimin dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet komunitetit gorar dhe institucioneve shtetërore, duke shërbyer si një pikë lidhëse dhe komunikimi për përcjelljen dhe trajtimin e çështjeve me interes për komunitetin. Ajo ka marrë pjesë vazhdimisht në takime, mbledhje dhe veprimtari të zhvilluara me gorarët që jetonin në Tiranë, duke kontribuar me mendimet, opinionet, përvojën dhe angazhimin e saj në çështjet që lidheshin me Gorën dhe komunitetin e saj. Në këtë mënyrë, edhe pas largimit nga zona, ajo vazhdoi të ruante një lidhje aktive dhe të pandërprerë me

komunitetin gorar, duke kontribuar në ruajtjen e marrëdhënieve ndërmjet gorarëve që jetonin në Tiranë, komunitetit që vazhdonte të jetonte në zonë dhe institucioneve shtetërore. Vlerësimi dhe rekomandimi i Shoqatës Veprimtaria e znj. Donika Rroko përfaqëson një kontribut shumëvjeçar dhe të vazhdueshëm në jetën ekonomike, shoqërore dhe komunitare të zonës së Gorës dhe Maliqit. Nga ushtrimi i detyrave me përgjegjësi në drejtimin e tregtisë në Lozhan dhe Maliq përpara viteve '90, vijimi për afro dy dekada i aktivitetit privat në Drithas, drejtimi rajonal i veprimtarisë së Shoqatës "Gora", deri te ushtrimi i rolit të Sekretares së Shoqatës në Tiranë dhe puna e saj për krijimin dhe forcimin e lidhjeve të komunitetit gorar me institucionet shtetërore, veprimtaria e saj dëshmon një angazhim të vazhdueshëm në shërbim të komunitetit. Për sa më sipër, Shoqata Atdhetare-Kulturore "Gora" shpreh vlerësimin dhe mirënjohjen për kontributin shumëvjeçar të znj. Donika Rroko dhe për rolin e saj profesional, drejtues, organizativ dhe shoqëror në shërbim të komunitetit.

Në vlerësim të veprimtarisë dhe kontributit të saj ndër vite, Shoqata Atdhetare-Kulturore "Gora" mbështet dhe rekomandon propozimin për përjetësimin e emrit dhe kujtimit të znj. Donika Rroko, nëpërmjet emërtimit me emrin "Donika Rroko" të një rruge, sheshi apo hapësire tjetër publike të përshtatshme në territorin e Bashkisë Maliq, me përparësi në zonën me të cilën lidhet jeta dhe veprimtaria e saj.

Shoqata vlerëson se një emërtim i tillë do të përbënte jo vetëm një nderim të kujtimit të saj, por edhe një njohje publike të kontributit të dhënë ndër vite në jetën ekonomike, shoqërore dhe komunitare të zonës dhe në ruajtjen e lidhjeve të komunitetit gorar.

Për këto arsye, Shoqata Atdhetare-Kulturore "Gora" i rekomandon Bashkisë Maliq dhe Këshillit Bashkiak Maliq marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin pozitiv të këtij propozimi.

Ky relacion lëshohet për t'u paraqitur pranë Bashkisë Maliq dhe Këshillit Bashkiak Maliq, si dokument mbështetës i propozimit për përjetësimin e emrit të znj. Donika Rroko.

KRYETARI SHOQATA ATDHETARE-KULTURORE "GORA"
Emër Mbiemër ALBERT M[illegible]

Nr. Prot.: 105

Datë: 12 / 10 / 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Tiranë

Njësia administrative Nr. 1

Zyra e Gjendjes Civile 373

Datë: 03.06.2026

CERTIFIKATË VDEKJE (NGA AKTI)

Në bazë të aktit të vdekjes nr. 45 datë 03.03.2026 vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	Donika
Mbiemri	HOXHALLI
Numri Personal	F85621023A
Emri i Babait	Fuat
Emri i Nënës	Sato
Datëlindja	21-06-1958 (pesëdhjetë e tetë)
Vendlindja	Senisht, Korçë
Vendbanimi	GJERGJ QIRJAZI; Nd. 11; H. 1; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 1; 1005; TIRANË
Gjinia	Femër
Gjendja Civile	I/e martuar
Shtetësia	Shqiptare
Data e vdekjes	03-03-2026
Vendi i vdekjes	Tirane ne shtepi
Shkaku i vdekjes	ca rektumi St.III

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Vulosur elektronikisht nga Ministria e Punëve të Brendshme
Date:2026/06/03 11:11:39 +02'00'
bff9ec51da36433291537a1ea45eef8920260603111138
6001001

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Ministria e Punëve të Brendshme)

BASHKIA MALIQ
Zyra e Protokollit
Nr. 5350 Prot.
Date 11.9.26 Nenshkrimi

KERKESE

Dt.11.09.2026

Drejtuar : Keshillit Bashkiak Maliq

Une I nenshkruari Fahri Avdulla Refatllari banues ne fshatin Symis te njesise administrative Libonik, shpreh kerkesen time si me poshte:

Kam me shume se 12 vjét qe vi ne bashki per te njejtin problem dhe akoma skam gjetur zgjidhje. Disa here kam shkuar ne bashki kam takuar pothuajse te gjithe per problemin tim por deri sot asnjegje. Shtepine e kam ndertuar ne vitin 1995 me mund dhe sacrifice si te gjithe shqiptaret por, perpara shtepise me kalojne ujrat e zeza ku ne fakt aty nuk ka pasur kanal, kur une kam ndertuar shtepine ka qene vetem rruge, ska pasur kanal. Me ndertimin e shtepive te tjera te gjithe I nxoren ujrat e zeza mbi rruge e cila kalon perpara shtepise. Sot qe flasim aty nuk jetohet jovetem nga era e keqe por edhe papastertia qe eshte kudo. Nga dita ne dite situata ndryshon dhe behet keq e me keq. Nga takimimet qe kam bere ne bashki me thone lloj lloj versionesh se si duhet te behet, heren e fundit me thane qe duhet nje projekt se eshte goxha investim. Po, nese eshte e nevojshme te behet projekt dhe te gjithe te gjejne zgjidhje.

I lutem Keshillit Bashkiak Maliq te me ndihmoje, te me japi nje zgjidhje pasi edhe une kam te drejte te jetoj normal.

Me respekt

Fahri Refatllari

- Keshilli
dt 11.09.2026

D.17.11.2026

BASHKIA MALIQ
Zyra e Protokollit
Nr.6936 Prot.
Date 18.11.26 Nënshkrimi

- kështu
dt 18.11.2026

Pleqësia e fshatit Zvarisht

Informacion

Drejtuar:Këshillit të Bashkisë Maliq

Lidhur me vendimin që ka marrë Këshilli i Bashkisë Maliq,për hapjen e një rruge që ka konflikt midis dy familjeve të Znj.Vasilika Boçi dhe Znj.Zengjine Bashllari .

Për këtë e bëjmë me dije Këshillin e Bashkisë Maliq dhe sqarojmë se: Kjo rrugë është mbyllur me kërkesë të pleqësisë të fshatit Zvarisht drejtuar ish Këshillit të Komunës Gorë më datë 03.06.2012 dhe me vendim të Këshillit të Komunës Gorë me Nr.Vendimi Nr.54 datë 31.08.2012 për arsye konflikti midis dy palëve dhe kjo rrugë nuk ka funksion për fshatin dhe personi që ka bërë ankesë ka rrugë për të komunikuar me shtëpinë .

Në emër të pleqësisë së fshatit dhe banorëve të fshatit Zvarisht,kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Maliq që para se të marri vendimin të verifikojë me një grup Këshilltarësh gjendjen në vend,pasi kjo rrugë është verifikuar edhe nga Kryetari i Bashkisë Maliq Z.Gëzim Topçiu.

Mbetemi në pritje për verifikimin e këtij problemi.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

Ky informacion shoqërohet me listën emërore të banorëve të fshatit Zvarisht e firmosur si më poshtë:

Kryetari i Fshatit Zvarisht Natiz Bashllari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ADMINISTRATIVE ZVARISHT GORË BASHKIA MALIQ

Banorët e fshatit Zvarisht:

1 Vasil's Boshllari
2 Yqmet Bashllari
3 Reshat Boshllari
4 Neri Rasha
5 Bardhyl Dyrri
6 Kadrime Mahmuti
7/ Begir Bashllari
8-1 Mani Bashllari
9-1 Driton Bashllari
10/ Myzafer Bashllari
11/ Fatmir Bolli
12/ Adriatik Bolli
13 Elmas Boshllari
Kadrenda Bashllari
Ajet Boshllari
Geftyon Bashllari
Albert Boshllari
Orges Boshllari
Festim Boshllari

REPUBLIKA E SHQIPERISE
QARKU KORÇE
KOMUNA GORE
KESHILLI I KOMUNES

VENDIM

Nr 54 Date 31.08.2012

PER BLLOKIMIN E RRUGES QE KALON PARA SHTEPISE SE ZJ .ZENGJINE BASHLLARI NË FSHATIN ZVARISHT

Mbeshtetur ne Ligjin 8652 date 31.07.2000"Per organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" neni 32, shkronja k, me propozim te Kryetarit te Komunes (bazuar ne procesverbalin e mbajtur nga Pleqesia e fshatit Zvarisht) Keshilli i Komunes

VENDOSI

1. Te bllokoje rrugen qe kalon Z. Zylyftar Bashllari para shtepise se Zj.Zengjine Bashllarit pasi i lart permenduri ka rruge tjeter per te kaluar dhe kalimi ne rrugen e larpërmendur sjell konflikt midis ketyre dy familjeve.
2. Ngarkohet per zbatimin e ketij vendimi Zyra e AMT te Komunes dhe urbanistikes.

KRYETARI I KOMUNES
Bujar Sallianji

KRYETARI I KESHILLIT
Dashnor Skenderi

SEKRETARI
Bedri Bashllari

Kryesia e Fshatit Zvarisht
Komuna Gorë

Data 3-VI-2012.

Në Kryesinë e fshatit Zvarisht janë paraqitur dy ankesa, ë nga Znj. Zengine Bashllari dhe tjetra nga z. Zylyftar Bashllari ~~Zenginja~~ Ankesa e znj. Zengine është për z. Zylyftar që i ka hapur nje rugë para shtëpisë, kjo rrugë nuk ka qenë më parë për Zylyftarin; urse ankesa e z. Zylyftar është për znj. Zengine, e cila nuk e jon të hapë këtë rrugë dhe të mos kalojë aty. Ky konflikt dira ditë që ka lindur. Kryesia e fshatit Zvarisht ka parë në nd këtë problem më shumë se dy herë. E kemi diskutuar përgjegjësi e seriozitet këtë problem. Duke mos u ërë palë me asnjërin konfliktues dhe duke menduar për zgjidhje sa me të drejtë të problemit Kryesia e fshatit Zvarisht në mbledhjen e saj të datës 3-VI-2012

Vendosi

1- Zylyftar Bashllari të mos kalojë në këtë rrugë. Ai ka shumë mundesira të tjera për të kaluar.
2- Kjo rrugë ka qënë dhe do të jetë për familjet e ~~Fatos dhe~~ Garip Bashllarit. Zengine Bashl.
- Kërkojmë ndihmën e Komunës për zbatimin e vendim

Për Kryesinë e Fshatit Zvarisht
Kryetari
Nafis Bashllari

Syrja Agolli